



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

*Qeveria - Vlada - Government*

Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo Unutrašnjih Poslova  
Ministry of Internal Affairs

Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 34 (2 dhe 3) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovës, Nenet: 7 dhe 9, Ministria e Punëve të Brendshme shpall:

## Konkurs

### Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

<b>Emri i grupit</b>	Specialistë të Përgjithshëm të Shkencave Politike
<b>Institucioni</b>	Ministria e Punëve të Brendshme
<b>Nr. i Referencës</b>	RN00011414
<b>Kodi</b>	RPC0005040
<b>Data e njoftimit</b>	06.04.2023
<b>Afati për aplikim</b>	27.04.2023 - 06.05.2023



## 1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

---

**Detyra: 1.** Mban përgjegjësi të plotë për ligjshmërinë e veprimeve gjatë kryerjes së detyrës;

**Detyra: 2.** Mbron interesat e shtetit të Kosovës, shtetasve si dhe personave juridik të Republikës së Kosovës në shtetin ku është akredituar dhe ushtron funksionet e tij;

**Detyra: 3.** Është përgjegjës për ruajtjen e rregullave për informacionin e klasifikuar edhe pas largimit nga Ministria e Punëve të Jashtme, si dhe siguron ruajtjen e të dhënave dhe informatave që i janë besuar;

**Detyra: 4.** Siguron neutralitetin e plotë në çfarëdo forme të aktivitetit të mundshëm politik në parti, organizatë apo shoqatë politike në kohën sa zgjatë shërbimi diplomatik përkatësisht përfaqësimi në kuadër të shërbimit të jashtëm;

**Detyra: 5.** Është përgjegjës për të manifestuar sjellje e qëndrim moral e profesional të denjë;

**Detyra: 6.** Është përgjegjës që në asnjë formë, të hapur apo të mbyllur në aktivitet zyrtar apo formë tjetër të kontaktit diplomatik gjatë shërbimit të mos bëjë deklarata apo të mos shfaqë bindje që janë të ndryshme me qëndrimin zyrtar të formuluar përmes akteve të institucioneve demokratike e kushtetuese të Republikës së Kosovës për politikën e jashtme

**Detyra: 7.** Të respektojë ligjet dhe rregulloret e shtetit ose të shteteve ku është akredituar dhe të mos përfshihet në veprimtari, të cilat mund të vlerësohen si ndërhyrje në punët e brendshme të shtetit ose të shteteve ku zhvillon veprimtarinë;

**Detyra: 8.** Të ushtrojë veprimtarinë e vet, në përputhje me imunitetet dhe privilegjet që gëzon si anëtar i misionit diplomatik;

**Detyra: 9.** Të mos ushtrojë në shtetin ku është akredituar, veprimtari tregtare ose çdo veprimtari tjetër fitimprurëse për llogari të tij ose të familjes së tij;

**Detyra: 10.** Kryen çdo detyrë tjetër në fushën profesionale specifike në përputhje me ligjet dhe rregulloret aktuale të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe.

## 2. Kërkesat e përgjithshme për pranim

---

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.



### 3. Kërkesat e përgjithshme formale

- Arsimitimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve në Shkenca Politike / Administratë Publike / Politika Sociale / Juridik.
- Kualifikime të posaçme formale: Njohja e gjuhës GREKE në nivelin C1-C2 (e obliguar). Njohja e gjuhës GREKE, dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime universitare të kryera në këtë gjuhë.
- Përvoja e punës e kërkuar: Së paku 1 (një) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.

### 4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme

- Njohuri të thellë dhe të specializuara në fushën profesionale specifike;
- Nivel të lartë të njohurive profesionale ose teknike të fushës përkatëse dhe të kuptuarit e fushave që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësit;
- Njohuri të mira metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike dhe në marrjen e vendimeve;
- Aftësi të arsytimit logjik dhe analizës;
- Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar;
- Njohja e gjuhës angleze (së paku në nivel bazik).

### 5. Pozitat aktualisht të lira

Kodi	Nr. i Referencës	Titulli i pozitës	Klasa e pozitës	Koeficienti	Institucioni	Organizata / Vendi i punës	Nr. i kërkuar
RPC0004272	RN00010602	Zyrtar i misionit diplomatik	Profesional 2	114-5.2	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës	Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës	1

### 6. Mënyra e aplikimit

Përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)



## 7. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

---

- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore, nostrifikimin për diplomat e marra jashtë vendit;
- Kopjet e dëshmisë së punësimit të cilave u bashkëngjitet së paku njëra nga dëshmitë mbështetëse si në vijim: pasqyrën e pagesave në fondin e kursimeve pensionale, pasqyrën e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale;
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve;
- Kopjet e dëshmisë së njohjes së gjuhës GREKE. Njohja e gjuhës GREKE, dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime universitare të kryera në këtë gjuhë
- Dëshmi përkatëse se kandidati/ja ka zotësi të plotë për të vepruar;
- Dëshmi mjekësore se kandidati/ja është në gjendje të mirë shëndetësore për të kryerjen e detyrës;
- Certifikatë/vërtetim nga Gjykata ose nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Kosovës me të cilin dëshmohet se nuk jeni dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje, jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj nga data e lëshimit;
- Nëse kohëzgjatja lidhur me përvojën e kërkuar e punës, është në sektorin publik, atëherë është i nevojshëm vërtetimi nga institucioni ku ka punuar kandidati/ja me të cilin dëshmohet se ai/ajo nuk gjendet në kushtet parashikuara në nenin 8 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.6) të Ligjit Nr.06/L – 114 për Zyrarët Publik.

•

## 8. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

---

- Testimi me shkrim
- Vlerësimi i biografisë
- Intervistë

## 9. Fusha e njohurive, cilësive dhe aftësive që do të vlerësohen

---

- Fasha e marrëdhënieve diplomatike, aftësitë hulumtuese, analitike, vlerësuese, formulim të rekomandimeve, këshillave, komunikimit dhe planifikimit si dhe njohurive, aftësive dhe cilësive tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

## 10. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

---

- Përmes email dhe portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

## 11. Shpallja e rezultateve përfundimtare

---

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.



**Të dhëna shtesë:**

- Pas përfundimit të procedurës së konkursit, kandidatët e përzgjedhur sistemohen në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, deri në plotësimin e kushteve formale për dërgimin e tyre në misione.
  
- Të gjitha dokumentet e dorëzuara siç kërkohen nga shpallja e konkurrit, kandidati, përmes aplikacionit, vetdeklaron se janë të vërteta dhe mban përgjegjësi për vërtetësinë e tyre. Deklarimi i rrejshëm paraqet shkak për përjashtimin nga procedura e pranimit.

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

